BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

# PLANI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2024

**Janar, 2024**

Plani vjetor i punës i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit për vitin 2024 është përpiluar në bazë të Udhëzimit për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e përpilimit të planit strategjik dhe planit vjetor të punës. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 131/18 më 17.7.2018), dhe në pajtim me Planin Strategjik të Byrosë për 2024-2026 (01-129/1 më 11.1.2024), Strategjia për arsim 2018 - 2025, prioritetet dhe qëllimet strategjike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, rrjedhimisht me prioritetet dhe qëllimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 (Vendim për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2023, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 156 më 5.12.2022).

Plani vjetor bazohet edhe në njohuritë nga analizat dhe raportet për zbatimin e planit të punës së Byrosë nga viti paraprak, mbi dinamikën e zbatimit të Konceptit të ri për arsimin fillor, nevojat e shprehura dhe të konstatuara nga hulumtimet e kryera, përmirësimin e cilësisë së teksteve shkollore, si dhe zhvillimin profesional dhe atë të karrierës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional.

Në planin e punës përcaktohen prioritetet në drejtim të përmirësimit të cilësisë së procesit edukativ-arsimor në shkolla dhe vazhdimit dhe zbatimit të proceseve reformuese në arsim, kërkime shkencore, përparimi dhe zhvillimi i veprimtarisë edukative-arsimore në arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe arsimin artistik, arsimin e mesëm profesional dhe arsimimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Në të njëjtën kohë, aktivitetet do të synojnë kërkimin, analizën dhe studimin e sistemeve arsimore, përpilimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve të reja mësimore, zhvillimin profesional dhe në karrierë të kuadrit edukativ- arsimor, ndjekjen dhe pasqyrimin e punës së personelit arsimor, mbështetjen e maturës shtetërore dhe të testimeve ndërkombëtare dhe testimit kombëtar.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit bashkëpunon dhe shkëmben përvoja me organizata dhe institucione, shoqata dhe fondacione në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe me organizata dhe institucione ndërkombëtare për realizimin e detyrave të caktuara.

**U.d. Drejtor**

**Nr.01-258/5**
**12.2.2024**
**Shkup**
(Versioni nr.2)

________________________________

**Abdulfeta Fetai**

# 1. PROGRAMET

Plani vjetor i punës i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit ka të bëjë me periudhën njëvjeçare, në të cilën operacionalizohen masat dhe aktivitetet e përfshira në programet dhe nënprogramet e Planit Strategjik të Byrosë për 2024-2026. Dokumenti është në funksion të realizimit të prioriteteve strategjike dhe qëllimeve parësore të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit për vitin 2024 të përfshira në Vendimin për prioritetet strategjike të Qeverisë për vitin 2024-2028 “rritja e cilësisë së arsimit me qasje për të gjithë, sipas kërkesës së tregut të punës, zhvillimi dhe promovimi i kulturës dhe sportit" dhe "zhvillimi i arsimit cilësor me qasje për të gjithë, që do të krijojë kuadër të aftë për të përmbushur nevojat e tregut të punës, të edukuar për të respektuar të drejtat civile, tolerancë reciproke dhe zhvillim të multikulturalizmit dhe ndërkulturalizmit". Gjithashtu, plani bazohet në Konceptin e miratuar për arsimin fillor (2021), si dhe në të gjitha aktet nënligjore dhe profesionale që lidhen me Konceptin, si dhe në përparësitë strategjike të Byrosë:

- avancimi dhe zhvillimi i procesit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- ngritja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe në karrierë të kuadrit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- përmirësimi i i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve;
- zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore-juridike të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

Me Planin Strategjik të Byrosë për periudhën 2024-2026 është planifikuar të realizohet 1 program me 7 nënprograme, të cilat i dedikohen përmirësimit të cilësisë së arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm.

Për programin dhe për secilin nga nënprogramet e parashikuara, të cilat nga ana e tyre kanë iniciuar masa, projekte dhe aktivitete, Plani Vjetor i Punës për vitin 2024 përcakton burimet e nevojshme dhe mjetet financiare për zbatimin, si dhe rezultatet e pritura të zbatimit përfundimtar.

PROGRAMI: ARSIM CILËSOR PARASHKOLLOR, FILLOR DHE TË MESËM

**Nënprogramet:**

1. Standardet e arsimit parashkollor
2. Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit fillor
3. Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit të mesëm (gjimnaz, artistik, gjimnazi i sportit, akademia e sportit, arsimi i mesëm profesional, arsimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe gjimnazi matematikë-informatikë)
4. Hulumtime për avancimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm
5. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i kuadrit edukativ-arsimor të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm
6. Ndjekja (monitorimi) dhe (vetë)vlerësimi i arritjeve të shkollës
7. Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike, përmbajtjet digjitale dhe kurset online

# 2. PLANI I PUNËS

## A. Programi dhe nënprogramet nga plani strategjik i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit

| PROGRAMI: ARSIM CILËSOR PARASHKOLLOR, FILLOR DHE I MESËM |
|---|
| **Lidhja me prioritetin dhe qëllimin parësor të Qeverisë:**<br>**Prioriteti strategjik**: "rritja e cilësisë së arsimit me qasje për të gjithë, sipas kërkesës së tregut të punës".<br>**Qëllimi parësor**: „zhvillimi i arsimit cilësor me qasje për të gjithë, që do të krijojë kuadër të aftë për të menduar logjik dhe kritik të bazuar në analiza dhe fakte" dhe „arsim në funksion të personave që do të respektojnë dhe do të promovojnë të drejtat qytetare, tolerancën, ndryshimet, edukimin në frymën e multikulturalizmit dhe interkuulturalizmit"<br>Gjithashtu, plani bazohet në Konceptin e hartuar për arsimin fillor (2021), si dhe të gjitha aktet nënligjore dhe aktet profesionale që lidhen me Konceptin. |
| **Lidhja me prioritetin dhe qëllimin parësor të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit**<br>**Prioritetet strategjike të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:**<br>• Avancimi dhe zhvillimi i procesit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;<br>• Ngritja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe në karrierë të kuadrit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;<br>• Përmirësimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve.<br>**Qëllimet parësore të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:**<br>• të implementohen reformat në arsimin fillor sipas Konceptit për arsim fillor;<br>• të krijohen standarde arsimore kombëtare dhe programe mësimore si dhe plane mësimore të arsimit të mesëm;<br>• të realizohen hulumtime për avancimin e arsimit;<br>• të implementohet Koncepti për arsimin gjithpërfshirës;<br>• të përmirësohen kompetencat e kuadrit edukativ-arsimor;<br>• të sigurohet monitorimi i mësimdhënësve përmes vizitave profesionale dhe sigurimin e zhvillimit të tyre në karrierë. |
| **Qëllimi i programit:**<br>- Përmirësimi i cilësisë së njohurive të fëmijëve dhe nxënësve |
| **Indikatorët e suksesit të programit:**<br>- Krijimi i standardeve të reja për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm |

- Hartimi i programeve të reja mësimore, koncepteve dhe akteve nënligjore
- Numri i hulumtimeve dhe analizave në fushën e arsimit (2023)
- Numri i kuadrit edukativ-arsimor të trajnuar me kompetenca të përforcuara (2023)
- Shtypja (botimi) dhe shpërndarja e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike (2023) dhe literaturë tjetër profesionale

**NËNPROGRAMI 1: Standardet e arsimit parashkollor**

**Qëllimi i nënprogramit**: Përmirësimi i cilësisë së arsimit parashkollor

| **Indikatorët e suksesit:** | **Pikënisja:** | **Rezultati i planifikuar (determinativ) në nivel vjetor:** |
|---|---|---|
| -programi për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijëve nga mosha 0 deri në 6 vjeç;<br><br>-dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike e përditësuar për kopshtet e fëmijëve;<br><br>- numri i kuadrit edukativ - arsimor të trajnuar për tema që kanë të bëjnë me procesin edukativ-arsimor | - rezultatet nga hulumtimi MELQO;<br>-rezultatet nga monitorimi i procesit edukativ-arsimor në kopshtet e fëmijëve;<br>-Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit të arsimit 2018-2025. | - modernizimi i arsimit parashkollor;<br><br>- inovacioni i veprimtarisë edukative-arsimore në arsimin parashkollor;<br><br>-përforcimi i kompetencave të kuadrit edukativ-arsimor për zhvillimin e Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm. |

| **Masat** | **Aktivitetet** | **Korniza kohore e realizimit** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Kuartali 1** | **Kuartali 2** | **Kuartali 3** | **Kuartali 4** | **Mjetet financiare (MKD)** | **Struktura/personi organizativ** |
| 1. Trajnime për kuadrin edukativ-arsimor për tema që kanë të bëjnë me procesin edukativ-arsimor në përputhje me kërkesat e | - Përpilimi i planit të trajnimit të kuadrit edukativ-arsimor; | ✓ | ✓<br><br>✓ | ✓ | ✓ | 100.000 | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore; |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qeverisë, MPPS, MASH dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin parashkollor. | - Përpilimi i moduleve për trajnim;<br>-Realizimi i trajnimeve të kuadrit edukativ-arsimor. | ✓<br>✓ | <br>✓ | ✓<br>✓ | ✓<br>✓ | | - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe mësimin klasor. |
| 2. Hulumtimi kryesor për matjen e cilësisë dhe mjedisit për mësim dhe zhvillim të hershëm - Aplikimi i instrumentit të plotë MELQO. | - Realizimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesionalë për Modelin Mele I dhe përgatitja për zbatimin e hulumtimit kryesor;<br><br>- Realizimi i hulumtimeve në terren. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | - Njësia e Projektit të Bankës Botërore;<br>- Sektori për mbrojtjen e fëmijëve;<br>- Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore;<br>- Njësia për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe mësimin klasor. |
| 3. Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm | - Hartimi i programit për mësim dhe zhvillim të hershëm. | ✓ | ✓ | ✓ | | 500.000 | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore;<br>- Njësia për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe mësimin klasor. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike për kopshtet e fëmijëve e përditësuar | - Rishikim i dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike për kopshtet e fëmijëve, | | | ✓ | ✓ | | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore;<br>- Njësia për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe mësimin klasor. |

| PROGRAMI 2: **Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit fillor** | | |
|---|---|---|
| **Qëllimi i nënprogramit:** Përmirësimi i cilësisë së arsimit fillor | | |
| **Indikatorët e suksesit:**<br><br>- përpilimi i planit mësimor për arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2024/2025;<br><br>- numri i programeve të reja mësimore;<br><br>- numri i kuadrit edukativ-arsimor të trajnuar për programet e reja mësimore dhe temave të tjera që kanë të bëjnë me procesin edukativ-arsimor; | **Pikënisja:**<br><br>- Ligji i Arsimit Fillor;<br>- Koncepti për arsimin fillor 2021;<br>- Ligji për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë; | **Rezultati i planifikuar (determinativ) në nivel vjetor:**<br><br>- modernizimi i arsimit fillor;<br><br>- inovacioni i veprimtarisë arsimore në arsimin fillor;<br><br>-përforcimi i kompetencave të kuadrit arsimor në shkollat fillore. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| - numri i koncepteve të përpiluara, akteve nënligjore, udhëzimeve dhe dokumenteve të tjera. | | - Strategjia gjithëpërfshirëse për zhvillimin e arsimit 2018 - 2025. | | | | | |
| **Masat** | **Aktivitetet** | **Korniza kohore e realizimit** | | | | | |
| | | **Kuartali 1** | **Kuartali 2** | **Kuartali 3** | **Kuartali 4** | **Mjetet financiare (MKD)** | **Struktura/personi organizativ** |
| 1. Programe të reja mësimore të bazuara në standardet kombëtare me rezultatet e të nxënit për lëndët mësimore të klasës së tetë dhe të nëntë në përputhje me planin mësimor nga Koncepti i arsimit fillor | - Përpilimi i programeve mësimore bazuar në standardet kombëtare me rezultate të nxënit për lëndët e klasës së tetë dhe të nëntë. | ✓ | ✓ | | | 1.000.000 | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore;<br>- Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në mësimin lëndor të arsimit fillor. |
| 2. Trajnime për kuadrin edukativ-arsimor të shkollave fillore për programet e reja mësimore dhe tema të tjera që kanë të bëjnë me procesin edukativ-arsimor në përputhje me kërkesat e Qeverisë, MPPS, MASH dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin fillor | - Përgatitja e planit për trajnimi të mësimdhënësve të shkollave fillore për programet e reja mësimore për lëndët e klasës së tretë dhe të gjashtë;<br><br>- Realizimi i trajnimeve për mësimdhënësit e shkollave fillore për | ✓ | ✓<br><br>✓ | ✓<br><br>✓ | | 500.000 | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore;<br>- Njësia për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe mësimin klasor;<br>- Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | programet e reja mësimore për lëndët mësimore për klasën e tretë dhe të gjashtë. | | | | | | programeve mësimore në mësimin lëndor të arsimit fillor. |
| 3. Konceptet, aktet nënligjore, udhëzimet dhe dokumente të tjera për arsimin fillor në përputhje me kërkesat e Qeverisë, MPPS-së, MASh-it, dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin fillor | - Hartimi i koncepteve, akteve nënligjore, udhëzimeve dhe dokumenteve tjera në përputhje me Ligjin për Arsimin Fillor, Ligjin për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional dhe Strategjinë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e arsimit 2018 - 2025. | ✔ | ✔ | ✔ | ✔ | 200.000 | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore;<br>- Njësia për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe mësimin klasor;<br>- Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në mësimin lëndor të arsimit fillor. |

| |
|---|
| NËNPROGRAMI 3: **Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit të mesëm (gjimnaz, artistik, gjimnazi i sportit, akademia e sportit, arsimi i mesëm profesional, arsimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe gjimnazi matematikë-informatikë)** |
| **Qëllimi i nënprogramit:** Përmirësimi i cilësisë së arsimit të mesëm |

<table>
<tr>
<td colspan="3">Indikatorët e suksesit:<br><br>- standardet kombëtare për kompetencat që duhet të kenë nxënësit në përfundim të arsimit të mesëm;<br><br>- numri i programeve të reja mësimore;<br><br>- numri i kuadrit arsimor të trajnuar për programet e reja mësimore dhe tema të tjera që kanë të bëjnë me procesin edukativ-arsimor;<br><br>- numri i programeve të reja të provimeve për lëndët e përgjithshme të maturës shtetërore dhe shkollore për nxënësit e arsimit të mesëm profesional katërvjeçar të reformuar, bazuar në rezultatet e të nxënit;<br><br>- numri i koncepteve të hartuara, akteve nënligjore, udhëzimeve dhe dokumenteve të tjera.</td>
<td colspan="2">Pikënisja:<br><br>- Ligji i Arsimit të Mesëm;<br>- Ligji për Gjimnazin Matematikë-Informatikë;<br>- Ligji për Arsim dhe Trajnim Profesional;<br>- Ligji për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional;<br>- Strategjia gjithëpërfshirëse për zhvillimin e arsimit 2018-2025.</td>
<td colspan="3">Rezultati i planifikuar (determinativ) në nivel vjetor:<br><br>- modernizimi i arsimit të mesëm;<br><br>- inovacioni i veprimtarisë edukative-arsimore në arsimin e mesëm;<br><br>- përforcimi i kompetencave të kuadrit arsimor të shkollave të mesme.</td>
</tr>
<tr>
<th rowspan="2">Masat</th>
<th rowspan="2">Aktivitetet</th>
<th colspan="4">Korniza kohore e realizimit</th>
<th rowspan="2">Mjetet financiare (MKD)</th>
<th rowspan="2">Struktura/personi organizativ</th>
</tr>
<tr>
<th>Kuartali 1</th>
<th>Kuartali 2</th>
<th>Kuartali 3</th>
<th>Kuartali 4</th>
</tr>
<tr>
<td>1. Standardet kombëtare të kompetencave që duhet të fitojnë nxënësit në përfundim të arsimit të mesëm</td>
<td>- Përpilimi i standardeve kombëtare për kompetencat që duhet të zotërojnë nxënësit në përfundim të arsimit të mesëm.</td>
<td></td>
<td>✓</td>
<td>✓</td>
<td>✓</td>
<td>500.000</td>
<td>- Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore;<br>- Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin gjimnaz, arsimin artistik dhe për</td>
</tr>
</table>

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | lëndët e përgjithshme të arsimit profesional. |
| 2. Programe të reja mësimore në përputhje me kërkesat e Qeverisë, MASh-it dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin e mesëm | - Përpilimi i programeve mësimore për lëndët mësimore (të detyrueshme dhe zgjedhore) për vitin IV (e katërt) të shkollës së mesme matematikë-informatike;<br><br>- Përpilimi i programeve mësimore për lëndët e përgjithshme të arsimit të mesëm profesional dyvjeçar dhe trevjeçar të përpiluar në mënyrë modulare dhe bazuar në rezultatet e të nxënit;<br><br>- Përpilimi i programeve të reja mësimore për arsimin e mesëm bazuar në standardet | | | ✓<br><br>✓<br><br>✓ | ✓<br><br>✓<br><br>✓ | | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore;<br>- Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin gjimnaz, arsimin artistik dhe për lëndët e përgjithshme të arsimit profesional. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | e reja dhe në rezultatet e të nxënit;<br><br>- Përpilimi i programeve të reja mësimore të provimeve për lëndët e përgjithshme të maturës shtetërore dhe shkollore për nxënësit e arsimit të mesëm profesional katërvjeçar të reformuar, bazuar në rezultatet e të nxënit. | ✓ | ✓ | | | | |
| 3. Trajnime sipas kërkesës së MASh-it dhe dinamikës së hyrjes së reformave në arsimin e mesëm | - Hartimi i planit për trajnim të kuadrit arsimor të shkollave të mesme (sipas kërkesës së MASh-it dhe eventualisht sipas fillimit të reformave);<br><br>-Realizimi i trajnimeve për kuadrin arsimor nga shkollat e mesme (sipas kërkesës së MASh-it dhe eventualisht sipas fillimit të reformave). | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | 200.000 | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore;<br>- Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin gjimnaz, arsimin artistik dhe për lëndët e përgjithshme të arsimit profesional. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. Koncepte, akte nënligjore, udhëzime dhe dokumente të tjera për arsimin e mesëm në përputhje me kërkesat e Qeverisë, MASH-it dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin e mesëm | - Përpilimi i koncepteve, akteve nënligjore, udhëzimeve dhe dokumenteve tjera në përputhje me Ligjin për Arsimin e Mesëm dhe Strategjinë Gjithëpërfshirëse për Zhvillimin e Arsimit 2018 - 2025;<br><br>- Përpilimi i testit të matematikës dhe fizikës për provimin pranues në Gjimnazin Matematikë-Informatikë për vitin shkollor 2024/2025;<br><br>- Përpilimi i testeve për testimin kualifikues në lëndët gjuhë amtare dhe matematikë për regjistrimin e nxënësve në arsimin e mesëm në vitin shkollor 2024/2025; | ✓<br><br>✓<br><br>✓ | ✓<br><br>✓<br><br>✓ | ✓ | ✓ | 500.000 | - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore;<br>- Njësia e zhvillimit të sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin gjimnaz, arsimin artistik dhe për lëndët e përgjithshme të arsimit profesional. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Përpilimi i testeve për testim kualifikues në lëndën e biologjisë dhe kimisë për regjistrimin e nxënësve në drejtimin shëndetësor të arsimit të mesëm profesional katërvjeçar në vitin shkollor 2024/2025. | ✓ | ✓ | | | | |

| NËNPROGRAMI 4: **Hulumtime për avancimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm** | | |
|---|---|---|
| **Qëllimi i nënprogramit:** Analiza dhe përcaktimi i përparimit në procesin arsimor në tema bazuar proceseve aktuale reformuese | | |
| **Indikatorët e suksesit:**<br>- Numri i analizave të teksteve shkollore dhe literaturës profesionale;<br>- Raporte nga hulumtimet e kryera;<br>- Koncepti i rishikuar për aktivitetet jashtëshkollore sipas arsimit fillor të reformuar;<br>- Përmbushja e planit të bashkëpunimit për zbatimin e projektit kërkimor në bashkëpunim me organizatat joqeveritare. | **Pikënisja:**<br><br>- Dokumentet strategjike;<br><br>- Aktet ligjore dhe nënligjore;<br><br>- Konceptet. | **Rezultati i planifikuar (determinativ) në nivel vjetor:**<br><br>- Studimi dhe përmirësimi i cilësisë së procesit edukativ-arsimor. |

| **Masat** | **Aktivitetet** | **Korniza kohore e realizimit** | | |
|---|---|---|---|---|

| | | Kuartali 1 | Kuartali 2 | Kuartali 3 | Kuartali 4 | Mjetet financiare (MKD) | Struktura/personi organizativ |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Analiza e teksteve shkollore, literaturës profesionale dhe revistave për fëmijë të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm | - Formimi i komisioneve për analizën e teksteve shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm;<br><br>- Përpilimi i mendimit profesional bazuar në analiza;<br><br>- Formimi i komisioneve për analizën e revistave për fëmijë dhe literaturës profesionale për edukimin dhe arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;<br><br>- Përpilimi i mendimit profesional bazuar në analiza. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | - Sektori i hulumtimit në arsim. |
| 2. Rishikim i Konceptit për aktivitetet jashtëmësimore në arsimin fillor | - Përpilimi i skicës konceptuale;<br><br>- Hartimi i Propozim-konceptit; | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | 300.000 | - Sektori i hulumtimit në arsim;<br>- Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimit të standardeve, planeve dhe programeve mësimore; |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Debat publik për konceptin;<br><br>- Koncepti i përpiluar me propozime të paraqitura nga debati publik;<br><br>- Dorëzimi për miratim nga ministri i Arsimit dhe Shkencës. | | | | | | - Një bashkëpunëtor i jashtëm nga institucionet e arsimit të lartë. |
| 3. Promovimi i rezultateve të hulumtimit për realizimin e lëndëve të lira zgjedhore në arsimin fillor | - Aktivitete përgatitore për botim elektronik të hulumtimit;<br><br>- Organizimi i një eventi publik për promovimin e rezultateve. | ✓ | | | | | - Sektori i hulumtimit në arsim;<br>- Sektori i logjistikës;<br>- Sektori i veprimtarisë botuese. |
| 4. Analiza e kërkesave për aprovimin e projekteve dhe hulumtimeve në arsimin fillor dhe të mesëm | - Analiza e projekteve;<br><br>- Përgatitja e mendimeve të ekspertëve. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | - Sektori i hulumtimit në arsim. |
| 5. Hulumtime për përmirësimin e aspekteve të rëndësishme të arsimit fillor dhe të mesëm | - Hulumtimi për realizimin e lëndëve të lira zgjedhore dhe aktiviteteve të lira zgjedhore në arsimin fillor; | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | 100.000 | - Sektori i hulumtimit në arsim;<br>- Njësia për hulumtim, zhvillim dhe çështje të sistemit;<br>- Dy bashkëpunëtorë të jashtëm nga institucionet e arsimit të lartë. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Përpilimi i metodologjisë dhe planit të veprimit;<br><br>- Instrumentet e hulumtimit, përpunimi i të dhënave;<br><br>- Përpilimi i raportit. | | | | | | |
| 6. Projekte shkencore-hulumtuese në fushën e AGjS-së | - Miratimi i memorandumit të bashkëpunimit;<br><br>- Përpilimi i Planit të veprimit për realizimin e aktiviteteve të projektit;<br><br>- Zbatimi i aktiviteteve sipas planit të veprimit;<br><br>- Përgatitja e Raportit për realizimin e aktiviteteve. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | - Sektori i hulumtimit në arsim;<br>- OJQ. |
| 7. Programi për mbrojtjen e konsumatorit | - Hartimi i programit për mbrojtjen e konsumatorit;<br><br>- Realizimi i aktiviteteve nga programi; | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | - Sektori i hulumtimit në arsim;<br>- Këshilltar i emëruar për realizimin e programit;<br>- ME;<br>- QRMV. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Përpilimi i raportit për aktivitetet e realizuara nga programi. | | | | | | |

| **NËNPROGRAMI 5:** Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i kuadrit edukativ-arsimor të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm | | |
|---|---|---|
| **Qëllimi i programit: Përmirësimi i kompetencave të kuadrit edukativ - arsimor** | | |
| **Indikatorët e suksesit:**<br><br>- Numri i vizitave të monitorimit dhe vlerësimit të punës së mësuesve dhe bashkëpunëtorëve profesional për vitin 2024;<br><br>- Numri i mësuesve dhe bashkëpunëtorëve të trajnuar përmes programeve të akredituara të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për vitin 2024;<br><br>- Numri i programeve të akredituara të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve. | **Pikënisja:**<br><br>- Ligji i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit;<br>- Ligji për Arsimin fillor;<br>- Ligji për Arsimin e mesëm;<br>- Ligji për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në arsimin fillor dhe të mesëm. | **Rezultati i planifikuar (determinativ) në nivel vjetor:**<br><br>- Vizita profesionale këshillimore të realizuara për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme;<br><br>- Trajnime të realizuara për aftësim profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional nga shkollat fillore dhe të mesme;<br><br>- Katalogu i lëshuar, plotësuar dhe publikuar i programeve të akredituara të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve. |

| **Masat** | **Aktivitetet** | **Korniza kohore për realizim** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Kuartali 1** | **Kuartali 2** | **Kuartali 3** | **Kuartali 4** | **Mjetet financiare (MKD)** | **Struktura/personi organizativ** |
| 1. Metodologjia dhe instrumente për monitorimin | - Formimi i grupit të punës; | ✓ | | | | | - Njësia për punë këshilluese - profesionale. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional | -Rishikimi i Rregullores për monitorimin dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional. | | | | | | |
| 2. Plani vjetor për monitorim dhe vlerësim të punës së mësuesve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë | - Hartimi i Planit vjetor sipas konkluzioneve të kolegjiumit dhe në bashkëpunim me sektorët tjerë të Byrosë. | ✓ | | ✓ | | | - Njësia për punë këshilluese - profesionale. |
| 3. Vizita për monitorimin dhe vlerësimin e punës së mësuesve dhe bashkëpunëtorëve profesional | - Përgatitja e Planit vjetor për monitorimin dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në përputhje me konkluzionet e kolegjiumit profesional dhe në bashkëpunim me sektorët tjerë të Byrosë;<br><br>- Realizimi i vizitave profesionale këshilluese të kuadrit edukativ-arsimor në shkollat fillore dhe të mesme; | ✓ | ✓ | | | 100.000 | - Njësia për punë profesionale-këshilluese. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Përgatitja e raporteve pas vizitave këshillimore të ekspertëve në shkollat fillore dhe të mesme. | | | | | | |
| 4. Analiza nga vizitat profesionale | - Hartimi i raporteve nga vizitat e realizuara këshilluese në shkollat fillore dhe të mesme. | | ✓ | | ✓ | | - Njësia për punë këshilluese - profesionale. |
| 5. Trajnime për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional të shkollave fillore për tema të zgjedhura nga Katalogu i programeve të akredituara të trajnimit | - Kontrata me ofrues të akredituar të shërbimeve për realizimin e trajnimeve sipas zgjedhjes së mësimdhënësve /bashkëpunëtorëve profesional;<br><br>- Miratimi i planit dhe dinamikës për realizimin e trajnimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve;<br><br>- Monitorimi i realizimit të trajnimeve dhe monitorimi i efekteve të tyre;<br><br>- Mbledhja e të gjithë dokumentacionit nga ofruesit e shërbimeve në lidhje me realizimin e trajnimeve për secilën temë veç e veç dhe dorëzimi i | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Mjetet janë të siguruara përmes projektit për avancimin e arsimit fillor nga Banka Botërore | -Njësia për zhvillim profesional e kuadrit edukativ-arsimor;<br>në bashkëpunim me:<br>- Sektorin për çështje financiare;<br>- Sektorin e Logjistikës;<br>- Njësia e projektit në MASH;<br>- Ofruesit e akredituar të shërbimeve. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | dokumentacionit të nevojshëm pranë Njësisë së Projektit në MASH (Projekti për përmirësimin e arsimit fillor - Banka Botërore);<br>- Përgatitja e raportit për aktivitet e kryera. | | | | | | |
| 6. Programet e akredituara të trajnimit dhe ofruesit e shërbimeve për trajnim të mësuesve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore | - Realizimi i veprimeve për publikimin e shpalljes publike dhe zgjedhja e ofruesit/ofruesve të programeve dhe shërbimeve. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Varësisht nga mjetet në dispozicion përmes projektit për avancimin e arsimit fillor të Bankës Botërore | - Njësia e zhvillimit profesional të kuadrit edukativo -arsimor në bashkëpunim me:<br>- Sektorin i çështjeve financiare;<br>- Sektorin e logjistikës;<br>- Komisionin për përzgjedhjen e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për aftësimin profesional të kuadrit edukativ -arsimor;<br>- Drejtori. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.a Programe të akredituara për trajnim dhe ofruesit e shërbimit për programet me prioritet të caktuara na Ministri për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollave fillore.<br>Trajnimet me prioritet dalin nga prioritetet e Qeverisë së RMV-së dhe janë në korrelacion me reformat që zbatohen në arsimin fillor si dhe nga hulumtimet relevante ndërkombëtare dhe raportet | - Realizimi i veprimeve për publikimin e shpalljes publike dhe zgjedhja e ofruesit/ofruesve të programeve dhe shërbimeve për realizimi e trajnimeve me përparësi<br><br>-Realizimi i trajnimeve për mësuesit dhe bashkëpunëtorët profesional nga ana ofruesit/ve të akreditũar | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | Varësisht nga mjetet në dispozicion përmes projektit për avancimin e arsimit fillor të Bankës Botërore | - Njësia e zhvillimit profesional të kuadrit edukativo -arsimor në bashkëpunim me:<br>- Sektorin i çështjeve financiare;<br>- Sektorin e logjistikës;<br>- Komisionin për përzgjedhjen e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për aftësimin profesional të kuadrit edukativ -arsimor;<br>- Drejtori;<br>- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës / Njësia e projekteve – projekt për avancimin e arsimit fillor. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7. Programet e akredituara të trajnimit dhe ofruesit e shërbimeve për trajnim të mësuesve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat e mesme dhe realizimi i trajnimeve për mësuesit/bashkëpunëtorët profesional të shkollave të mesme | - Iniciativa për nevojën e shpalljes publike për realizimin e trajnimit me temë konkrete deri te drejtori i Byrosë;<br><br>- Vendimi për publikimin e shpalljes publike nga drejtori i BZhA-së;<br><br>- Aktvendim për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve;<br><br>- Dorëzimi i propozim-shpalljes publike dhe dokumentacionit nga Komisioni deri te drejtori i BZhA-së;<br><br>- Publikimi i shpalljes publike;<br><br>- Vlerësimi i aplikacioneve të ofruesve të trajnimeve dhe shërbimeve nga Komisioni; | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | 5.000.000 | - Njësia e zhvillimit profesional të kuadrit edukativo -arsimor në bashkëpunim me:<br>- Sektorin i çështjeve financiare;<br>- Sektorin e logjistikës;<br>- Komisionin për përzgjedhjen e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për aftësimin profesional të kuadrit edukativ - arsimor;<br>- Drejtori. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Dorëzimi Raportit të vlerësimi me një rang listë dhe propozim për zgjedhjen e ofruesit/ve më të favorshëm të trajnimit dhe shërbimeve ose për anulimin e veprimit nga ana e Komisionit deri te drejtori i BZhA-se;<br><br>- Vendimi për zgjedhjen e ofertuesve më të volitshëm ose kryerja e moszgjidhjes ose anulimi i veprimit.<br><br>- Aktvendimi për akreditimin e programit/programeve të trajnimit dhe ofertuesve të shërbimeve. | | | | | | |
| 8. Monitorimi i shërbimeve të institucioneve, organizatave dhe personave të tjerë juridikë të akredituar, për sa i përket cilësisë dhe kryerjes së shërbimeve sipas afateve të përcaktuara. | - Formimi i ekipeve për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve të ofruesve të akredituar;<br><br>- Dorëzimi i Raportit përmbledhës për monitorimin dhe vlerësimin e trajnimeve. | | ✓ | | ✓ | | - Njësia për zhvillim profesional të kuadrit edukativ-arsimor;<br>- Këshilltarë nga sektorët e tjerë të BZhA - së. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9. Analiza e nevojave për zhvillim profesional të kuadrit arsimor | - realizimi i anketimit për nevojat për trajnim të kuadrit arsimor përmes pyetësorëve të përgatitur;<br><br>-Përpilimi i një analize nga pyetësorët për nevojat për trajnim të kuadrit arsimor | | ✓ | | | | - Njësia për zhvillim profesional të kuadrit edukativ-arsimor. |
| 10. Aktivitete për zhvillimin e karrierës së mësimdhënësve /bashkëpunëtorëve profesional. Monitorimi dhe vlerësimi i punës së mësuesve dhe bashkëpunëtorëve profesional kandidatë për avancim në titull, përmes mbikëqyrjes në plotësim të standardeve profesionale në pjesën e praktikës profesionale. | - Përgatitja e planit për monitorimin dhe vlerësimin e punës së kandidatëve sipas kërkesës së paraqitur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe listës së kandidatëve që aplikuan në shpalljen publike, sipas lëndës mësimore, gjuhës mësimore dhe këshilltarit;<br><br>- Dorëzimi i notave për plotësimin e standardeve në MASh për secilin prej kandidatëve që monitorohen dhe vlerësohen nga Byroja; | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | - Njësia për zhvillim profesional të kuadrit edukativ-arsimor;<br>- Këshilltarë nga sektorët e tjerë të BZhA - së. |

**NËNPROGRAMI 6: Monitorimi dhe evaluimi i arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve**

**Qëllimet e nënprogramit: Përmirësimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve**

| **Indikatorët e suksesit:** | **Pikënisja:** | **Rezultati i planifikuar (determinativ) në nivel vjetor:** |
|---|---|---|
| - krijimi i instrumenteve për vetëevaluimin e shkollave;<br><br>- numri i drejtorëve, shërbimit profesional dhe mësimdhënësve të trajnuar;<br><br>- hartimi i udhëzuesve për vlerësim objektiv. | - Ligji i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit;<br>- Ligji për Arsimin fillor;<br>- Ligji për Arsimin e mesëm;<br>- Ligji për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në arsimin fillor dhe të mesëm. | - Cilësi më e lartë e procesit arsimor. |

| **Masat** | **Aktivitetet** | **Korniza kohore për realizim** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Kuartali 1** | **Kuartali 2** | **Kuartali 3** | **Kuartali 4** | **Mjetet financiare (MKD)** | **Struktura/personi organizativ** |
| 1. Propozimi i masave konkrete për përmirësim të rezultateve nga PISA 2022 (kontrolle eksterne) | - Aktivitete sipas masave të propozuara për përmirësimin e rezultateve. | ✓ | ✓ | ✓ | | | - Sektori për monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve;<br>- Këshilltarë nga sektorët tjerë të Byrosë. |
| 2. Trajnime për mësuesit e shkollave të mesme në funksion të përmirësimit të rezultateve për lëndët Matematikë dhe Shkenca | - Përgatitja e materialeve dhe planit për trajnim të mësuesve. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | 100.000 | - Sektori për monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve;<br>- Këshilltarë nga sektorët tjerë të Byrosë. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| natyrore për PISA 2025 (kontrollë eksterne) | | | | | | | |
| 3. Trajnime për mësuesit e shkollave fillore në funksion të përmirësimit të rezultateve për lëndët Matematikë dhe Shkenca natyrore për TIMSS | - Përgatitja e materialeve dhe planit për trajnim të mësuesve. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | - Sektori për monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve;<br>- Këshilltarë nga sektorët tjerë të Byrosë. |
| 4. Propozimi i masave konkrete për përmirësimin e rezultateve të arritjeve të nxënësve në TIMSS 2023 | - Aktivitete sipas masave të propozuara për përmirësimin e rezultateve, | | | | ✓ | / | - Sektori për monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve;<br>- Këshilltarë nga sektorë të tjerë. |

| | | |
|---|---|---|
| **NËNPROGRAMI 7: Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike, përmbajtjet digjitale dhe kurset online** | | |
| **Qëllimi i nënprogramit:** Botimi dhe shpërndarja e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike për arsimin fillor dhe të mesëm, kurset online dhe platforma nacionale për loja digjitale | | |
| **Indikatorët e suksesit:**<br><br>- Numri i formularëve të përpunuar për arsimin fillor;<br><br>-Propozim plani botues për vitin 2025; | **Pikënisja:**<br><br>- Ligji i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit;<br>- Ligji për Arsimin fillor; | **Rezultati i planifikuar (determinativ) në nivel vjetor:**<br><br>- Botimi dhe shpërndarja e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike për arsimin fillor dhe të mesëm për vitin 2024; |

| | | |
|---|---|---|
| - Numri i literaturës tjetër profesionale të botuar;<br><br>- Numri i përdoruesve të kursit online;<br><br>-Numri i përdoruesve që propozojnë lojëra digjitale dhe përdorin përmbajtje dhe lojëra digjitale të përfshira në platformën kombëtare për lojërat digjitale. | - Ligji për Arsimin e mesëm;<br>- Ligji për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë. | - Njohuri të thelluara profesionale të kuadrit arsimor pas ndjekjes së kursit online. |

| Masat | Aktivitetet | Korniza kohore për realizim | | | | Mjetet financiare (MKD) | Struktura/personi organizativ |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kuartali 1 | Kuartali 2 | Kuartali 3 | Kuartali 4 | | |
| 1.Formularët e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike për arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhën maqedonase me përkthim në gjuhën shqipe, turke, serbe dhe boshnjake) | - Përpilimi i formularëve në gjuhën maqedonase për arsimin fillor dhe të mesëm;<br><br>- Lekturë e formularëve në gjuhën maqedonase për arsimin fillor dhe të mesëm;<br><br>-Redaktimi teknik i formularëve në gjuhën maqedonase për arsimin fillor dhe të mesëm;<br><br>-Lekturë e formularëve të përkthyer në gjuhën | ✔ | ✔ | ✔ | ✔ | 300.000 | - Sektori për veprimtari botuese;<br>- Njësia për veprimtarinë botuese dhe dokumentacionin pedagogjik;<br>- Njësia për zhvillimin e përmbajtjeve digjitale dhe kurseve online;<br>- Bashkëpunëtorë të jashtëm (lektorë, përkthyes, radhitës grafik). |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | shqipe, turke, serbe dhe boshnjake;<br><br>-Redaktimi teknik i formularëve të përkthyer. | | | | | | |
| 2. Botimi dhe shpërndarja e formularëve të dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike për arsimin fillor dhe të mesëm (në gjuhën maqedonase, shqipe, turke, serbe dhe boshnjake) | - Kontrolli dhe aprovimi i rregullimit teknik të formularëve të shkollave fillore dhe të mesme të shtypura në shtypshkronjë;<br><br>-Kontrolli i cilësisë së formularëve për shkollat fillore dhe të mesme të botuar nga shtypshkronja dhe raporti i kontrollit;<br><br>- Përgatitja e rishikimeve për shpërndarje të evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik për shkollat fillore dhe të mesme për vitin shkollor 2023/2024 dhe 2024/2025;<br><br>-Dorëzimi i porosive për botim në shtypshkronjë. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | 8.250.000 | - Sektori për veprimtari botuese;<br>- Njësia për veprimtarinë botuese dhe dokumentacionin pedagogjik;<br>- Bashkëpunëtorë të jashtëm. (lektorë, përkthyes);<br>- Punonjësit e NP në BRO;<br>- Drejtor. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. Të dhënat e përgjithshme të shkollave fillore dhe të mesme (mbledhja, përditësimi dhe përpunimi i tyre sipas gjuhës së mësimit, të dhënat e përgjithshme dhe numri i paraleleve dhe nxënësve për vitin shkollor 2024/2025) | - Vendosja e të dhënave sipas gjuhës mësimore në bazat e përgjithshme për të dhënat e përgjithshme dhe të dhënat për numrin e paraleleve dhe nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin shkollor 2024/2025;<br><br>- Përpunimi i të dhënave sipas gjuhës mësimore në bazat e përgjithshme për të dhënat e përgjithshme dhe të dhënat për numrin e paraleleve dhe nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin shkollor 2024/2025;<br><br>-Përpunimi i të dhënave sipas gjuhës mësimore të kandidatëve të paraqitur të cilët do të kalojnë maturën shtetërore për vitin shkollor 2023/2024; | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | - Sektori për veprimtari botuese;<br>- Njësia për veprimtarinë botuese dhe dokumentacionin pedagogjik;<br>- QSHP. |
| 4. Propozim – Plani i botimit për vitin 2025 | - Përpilimi i planeve;<br><br>-Përgatitja e raporteve: | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | 100.000 | - Sektori i veprimtarisë botuese; |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1. Krahasimi i shpërndarjes së kryer të evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik për shkollat fillore dhe të mesme të tre viteve të kaluara;<br>2. Krahasimi i botimit aktual të evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik nga magazina e BZHA të tre viteve të kaluara;<br><br>-Përgatitja e Propozim-planit të botimit për vitin 2025;<br><br>-Dorëzimi i Propozim-planit të botimit 2025. | | | | | | - Njësia e veprimtarisë botuese dhe dokumentacioni pedagogjik;<br>- Sektori i çështjeve financiare;<br>- Këshilli botues;<br>- Drejtori. |
| 5. Përmbajtje digjitale për trajnimin e këshilltarëve të BZHA | - Organizimi i procesit të trajnimit të këshilltarëve për përmbajtje digjitale. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | Njësia për zhvillimin e përmbajtjeve digjitale dhe kurseve online. |
| 6. Ueb platforma kombëtare për përmbajtje dhe materiale digjitale për edukatorët, mësuesit e shkollave fillore | - Organizimi i procesit për përzgjedhjen e përmbajtjeve të përshtatshme digjitale dhe qasjen apo përfshirjen e tyre në një ueb portal të | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | - Njësia për zhvillimin e përmbajtjeve digjitale dhe kurseve online. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| dhe prindërit (e përfshirë, e mirëmbajtur dhe e pasuruar) | përshtatshëm dhe në platformën kombëtare për lojërat digjitale;<br><br>-Realizimi i kursit online për mësimdhënësit e arsimit fillor dhe të mesëm. | | | | | | |
| 7. Botimi i literaturës profesionale (manualë, udhëzime, botime, raporte kërkimore, raporte analizash, etj.) dhe revista profesionale shkencore. | Përpunimi teknik i botimeve të planifikuara për botimin;<br><br>- Korrigjimin dhe lektorimin e publikimeve për botim;<br><br>- Përkthimi i botimeve në gjuhën shqipe dhe turke;<br><br>- Bashkëpunimi me BUKSh "Shën Klimenti i Ohrit" për marrjen e numrit CIP dhe ISBNN;<br><br>- Shtypja dhe shpërndarja e botimeve. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | - Sektori për veprimtari botuese. |
| 8. Materialet për mësim, manual për mësuesit dhe mjetet tjera didaktike | - Organizimi i procesit të botimit të materialeve. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | - Sektori për veprimtari botuese. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9. Fondi i rritur i literaturës profesionale në bibliotekën e BZhA-së. | -Pasurimi i bibliotekës së BZhA-së me literaturë profesionale dhe të tjera. | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | 200.000 | - Sektori për veprimtari botuese. |

**B. Masat dhe aktivitetet që dalin nga funksionimi i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit**

| PËRSHKRIMI DHE QËLLIMI I MASËS: **Funksionet e përbashkëta** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Indikatorët e suksesit:** | | | | | | |
| **Aktiviteti** | **Korniza kohore për realizim** | | | | | |
| | **Kuartali 1** | **Kuartali 2** | **Kuartali 3** | **Kuartali 4** | **Mjetet financiare (MKD)** | **Struktura/personi organizativ** |
| 1. Plani strategjik i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit për vitin 2024-2026 | ✓ | | | | / | Njësia e planifikimit strategjik, krijimi i politikave dhe monitorimi |
| 2. Plani Vjetor për punën e Byrosë për vitin 2024 | ✓ | | | | / | Njësia e planifikimit strategjik, krijimi i politikave dhe monitorimi |
| 3. Draft – plani strategjik për vitin 2025-2027 | | ✓ | ✓ | | / | Njësia e planifikimit strategjik, krijimi i politikave dhe monitorimi |
| 4. Raporti për realizimin e PVP të Byrosë për vitin 2023 | ✓ | | | | / | Njësia e planifikimit strategjik, krijimi i politikave dhe monitorimi |
| 5. Akti i sistematizimit të vendeve të punës (teksti i konsoliduar) në përputhje me dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik | ✓ | | | | / | Njësia e menaxhimit me burime njerëzore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6. Plani Vjetor për punësim për vitin 2025 | | | ✓ | | / | Njësia e menaxhimit me burime njerëzore |
| 7. Raporti gjashtëmujor (korrik-dhjetor 2023) për zbatimin e Planit Vjetor të punësimit për vitin 2023 | ✓ | | | | / | Njësia e menaxhimit me burime njerëzore |
| 8. Raporti gjashtëmujor (janar-qershor 2024) për zbatimin e planit vjetor të punësimit për vitin 2024 | | | ✓ | | / | Njësia e menaxhimit me burime njerëzore |
| 9. Plani Vjetor i trajnimit për nëpunësit administrativ të Byrosë për vitin 2025 | | | | ✓ | / | Njësia e menaxhimit me burime njerëzore |
| 10. Raport për zbatimin e planit vjetor të trajnimit për nëpunësit administrativë të Byrosë për vitin 2024 | | | | ✓ | / | Njësia e menaxhimit me burime njerëzore |
| 11. Raport me renditje të notave vjetore për të gjithë nëpunësit administrativë të vlerësimit në institucion për vitin paraprak | | | | ✓ | / | Njësia e menaxhimit me burime njerëzore |
| 12. Raport për punën e Byrosë, në pajtim me Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (barazi gjinore) | ✓ | | | | / | Njësia e menaxhimit me burime njerëzore |
| 13. Raport vjetor për masat e shqiptuara për përgjegjësi të përcaktuar disiplinore dhe materiale të nëpunësve administrativë të Byrosë për vitin paraprak | | | | ✓ | / | Njësia e menaxhimit me burime njerëzore |
| 14. Shpërndarja e brendshme e totalit të buxhetit të miratuar për vitin 2024 | ✓ | | | | / | Sektori për çështje financiare |
| 15. Vendime për autorizime të përgjithshme | ✓ | | | | / | Sektori për çështje financiare |
| 16. Plani Vjetor, tremujor dhe mujor për vitin 2024 | ✓ | | | | / | Sektori për çështje financiare |
| 17. Raporti vjetor financiar për vitin 2023 | | ✓ | | | / | Sektori për çështje financiare |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18. Llogaria përfundimtare për llogarinë buxhetore, llogaria për aktivitete vetëfinancuese dhe llogaria për donacione | ✓ | | | | / | Sektori për çështje financiare |
| 19. Kontrolli i detyrimeve financiare të obliguar për pagesë, hartimi i listës kontrolluese dhe pagesa | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | Sektori për çështje financiare |
| 20. Raporte për detyrimet e papaguara | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | Sektori për çështje financiare |
| 21. Raporte për paraqitjen e detyrimeve, borxheve dhe kërkesave | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | Sektori për çështje financiare |
| 22. Rebalanci i buxhetit për vitin vijues | | | ✓ | | / | Sektori për çështje financiare |
| 23. Propozim buxheti për vitin 2025, 2026, 2027, 2028 dhe 2029 | | ✓ | ✓ | | / | Sektori për çështje financiare |
| 24. Propozim-llogaria buxhetore në pajtim Draft-planin strategjik | | ✓ | ✓ | | / | Sektori për çështje financiare |
| 25. Përgatitja e llogarive për pagat e punonjësve dhe pagesa e tyre | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | |
| 26. Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit | ✓ | | | | / | Sektori për çështje financiare |
| 27. Rregullore për organizimin e brendshëm | ✓ | | | | / | Sektori i logjistikës |
| 28. Akti për sistematizimin e vendeve të punës | ✓ | | | | / | Sektori i logjistikës |
| 29. Shpallje publike për zbatimin e procedurës për akreditimin dhe përzgjedhjen e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për zhvillimin profesional të stafit arsimor dhe udhëheqës | ✓ | ✓ | | | 100.000 | Sektori i logjistikës |
| 30. Shpallje publike për ofrimin e shërbimeve në lidhje me hulumtimet shkencore | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | Sektori i logjistikës |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 31. Konkurs publik për punësimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | Sektori i logjistikës |
| 32. Plani i furnizimit publik | ✓ | | | | / | Sektori i logjistikës |
| 33. Aktet ligjore dhe nënligjore | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | / | Sektori i logjistikës |